


# POEZI NGA LIBRI I FREDERICK TURNER-it: "Në Shpellën e Platonit"



Gjekë Marinaj

## SHKURTIMISHT:

Frederick Turner u lind në Northamptonshire, Angli, në vitin 1943. Pasi kaloi disa vite në Amerikën Qendrore, ku prinderit e tij Viktor W. dhe Edith L. B. Turner po bënin kërkime shkencore, Turner u edukua në Universitetin e Oxford-it (1962-1967), ku fitoi gradët B.A., M.A. and B.Litt. (një gradë ekuivalente me Ph.D.) në gjuhën dhe letërsinë angleze. Turner u natyralizua si qytetar amerikan në 1997. Ai është Profesori Themelues i Arteve dhe Humanitetit në Universitetin e Teksasit, në Dallas, por që ka mbajtur pozita akademike në Universitetin e Kalifornisë në Santa Barbara, Kenyon College, dhe në Universitetin Exeter në Angli. Nga viti 1978-82 ka qenë redaktori i revistës The Kenyon Review. Turner është i martuar që nga viti 1966 me Mei Lin Turner (redaktore periodikes letrare nëe Chang) dhe ka dy djem. Ka botuar këto Libra:

Shakespeare and the Nature of Time (Oxford, Clarendon Press, 1971; criticism); Between Two Lives (Wesleyan University Press, 1972; poetry); Shakespeare's Romeo and Juliet (London University Press, 1974; edition with notes and introduction); Counter-Terra (Christopher's Books, 1978; poetry); A Double Shadow (Putnam's/Berkley, 1978; a science fiction novel); The Return (Countryman Press, 1979; poetry); The Garden (Ptyx Press, 1985; poetry); The New World (Princeton University Press, 1985; an epic poem); Natural Classicism: Essays on Literature and Science (Paragon House, 1985) (Reprinted in paperback by University Press of Virginia, 1992); Genesis (Saybrook Publishing Co./Norton, 1988; an epic poem); Rebirth of Value: Meditations on Beauty, Ecology, Religion and Education (State University of New York Press, 1991); Tempest, Flute, and Oz: Essays on the Future (Persea Books, 1992); Beauty: The Value of Values (University Press of Virginia, 1992); April Wind (University Press of Virginia, 1992; poetry); Foamy Sky: The Major Poems of Miklós Radnóti (with Zsuzsanna Osváth; Princeton University Press, Lockert Series, 1992; translations from the Hungarian); The Culture of Hope: A New Birth of the Classical Spirit (The Free Press, 1995); The Ballad of the Good Cowboy (The Maverick Press, 1997); Biopoetics: Evolutionary Explorations in the Arts (Paragon House Press, 1999; edited volume of essays by various hands, with Brett Cooke), Hadean Eclogues (Story Line Press, 1999; poetry); Shakespeare's Twenty-first Century Economics: The Morality of Love and Money (Oxford University Press, 1999); The Iron-blue Vault: Selected Poems by Attila József (Bloodaxe Books, 1999; translations, with Zsuzsanna Osváth); On the Field of Life, on the Battlefield of Truth (Pivot Press, 2004; poetry); and Paradise: Selected Poems, 1990-2003 (David Robert Books, 2004; poetry).

## TE QAFA E PRAUTËS, MAINE

Kush i stolisë këta gurë të bluar imët vetëm keshtu? Kush u dha jetë me kaq qejf boronicave? Kush ia ndaloj rritjen pishës, kush e ndezë ashtu Çiltërsinë kaq vajzërore të trëndafilave?

Rrëshirës së shlyer, virgjërisë së luleve të freskëta, Guralecëve të lumit që kërcasin si ksilonfon, Manushaqeve të shkruara me vjoska të qelqta, Shtat-lartësinë e padëshiruar kush ua ndalon?

Kush ia jep gjelberimt brilant epërsinë Valëvitetin degëve, si fletë të hapura ftese, Që pas pak jetësohen në një embëlsirë Dhe kthehen shijshëm në një tortë martese—

Që e ljen gjithësinë me një shkëlqim blu? Gjithë at' mahi e keni bërë ju. Ju, të gjithë ju.

## A MUND TË JETË

A ka mundësi të jetë  
Ky oborr i gjelbër në periferi,  
Hapur bri një peme,  
Qëndisur me veshtulli—  
Trina e një pëllëmbë prej hardhie;  
Ku pëllumbat ngrënë folënë,  
Ku Uisteria dhe Jesemia—  
Alfabeti i parajsës të jenë?  
E çfarë nëse unë,  
Pas kaq vite përpjekjesh kote,  
Ky Odise, luftëtari i gjërvave bajate,  
Në të folurën më të thellë të botës,  
Pas të gjitha sorollatjeve,  
T'i tregoj botës se gati besova,  
Duke kërkuar shenjat e botës në ato që njihja,  
Këtu ku të mashtron vet koha,  
Përgjigjen nën këmbë e kisha dhe s'e shihja.  
E çfarë nëse ky oborr ka një të fshehtë,  
Që asnjë nga ne zbuluesit  
Kurrë s'do të donim ta mësonim?  
E çfarë nëse pema  
Të jetë aq kulpëruar  
Sa ato që do jenë dhe ato që kurrë nuk do jenë  
Të mund të kenë hapësirën e tyre të rritjes?  
Çerdhet e dallëndyshevë,  
Në këtë oborr tashme tekancak,  
Mund të jenë të vetmet shenja që do kemi  
Për madhështinë e parajsës se gjelbër në arkipelag.

## HAIK PANTEIST

Flas me macen time  
Teksa sytë e saj blu ma skanojnë fytyrën.  
Mendimet e kujt jeni ne, atëherë?

## MBRËMJE PRANVERORE

Përbimi retë pudër fëmije  
Qielli shndrit porcelan blu.  
Yjet, plot epshe djalërie,  
Shtynjë retë me bërryla tej tehu.  
  
Kjo është përpjekja e tyre e parë,  
Që ata rendin pas mundësive;  
Ky është muzgu i krijimtarisë  
Kjo është koha e vetë perëndive.

## STËRVITJE NË KARATE: NATË VERE NË PARKUN "KROULY"

Është kaq e ëmbël, kaq e pazëshme, kjo fuqi e riuar.  
Rrjedhë me vrull përmes gjymtirëve dhe gjoksit  
Sa një shamatë e llahtarshme më mbanë të padësh-përuar.

Frymëmarrija është e lehtë, këmbët janë të ngulura;  
Çdo hap në barin e errët ndjekë një harkim;  
Çdo goditje dhe mbrojtje bie në pikat e duhura.

Dhe tanë një hënë e re antike ngjitet ngadalë,  
Më lart se çatitë e largëta, ndriçuese gjër thellë në gjak,  
Atha se vet grushti i zotit ngjitet i rëndë dhe i artë.

## ODE ATYRE QË I DUAN TË TJERËT

Ju kapa lettrash në dosje të brishta  
Jeni të gjitha të denja në vettvetë.  
Vesh-qene, të ndotura nga vaji i gishtave,  
Endëroni këtu në raftet plot heshtje.

Tensioni në molekulat tuaja diçka tjerrë  
I detyruar nga shanset kote të botes  
Shtynë përparrë kundra trashamanëve të tjere  
Tërhequr poshtë nga pisllëqet e trasha të tokës.

Ndonëse nga bukuria s'jeni gjigante  
Ju jeni nga gjerat që mbijetojnë kohën  
Ne morëm kafkën e drunjë dhe elegante  
Dhe si drithë e bluan imët në një mokër,

Dhe akoma shpirrat tek rafti i mbanë në zi  
Të shtypur dhe të rishkuar plot mund,  
Askush nuk ka guxuar, veç kjo poezi,  
Të thoshte se ai që i dashuri juaj gjë në fund.

## STUHIA E AKULLT

Në puhinë e akullt të gjitha tingëllimat dhe gjëmat  
E heshtjes. Toka është e bardhë, qielli i errët.  
Tkurret,  
Degëzimi mijegullor që valëzon me delikatesë pemët.  
Plot rënkimë ulen dhe përqafojnë dheun pishat dhe shkurret.  
Kjo është toka komode e vdekjes. Çdo vezullim  
Një koral i kulluar, pjesë e një guri të çaraveshur,  
Në nivelin e lartësisë së shpatullave, nga nxitimi  
Një lule në të çelur i ngjanë një mëngë të përveshur.  
Korja e tharë është një daulle në pëshpërimë  
Teksa bryma elektrike tjetërsohet në një rrëshqitës,  
Dhe trungjet e pemëve vizatohen ashpër me thëngjji  
Të bëhen shtyllëza lidhëse të skeçeve së ngricës.  
A mund të mbetet kaq i çuditshëm fundi e botës—  
Zhurmë e heshtur, bardhësi e nxirë, pezzullim në lëvizje, dhimbje  
E kthyer në lumturi?

## NGRICE

Më në fund, sot, është gjithçka kristalore.  
Një impuls i vjetruar tek një urdhër kozmik,  
Pastaj janë gjallesat ose patelina  
E ka kapur gjithë rritjen dhe e mbanë atë në kufi  
Mes të ardhmes dhe të kaluarës. Një shkëlqim  
I kthjellët pezullimi, i thjeshtë, i saktë,  
Fluturon tek syri i pikturuar nga pisha e akullt,  
Çdo detaj një skeç i saktë i gjithësisë.  
Ky është varrimi i urdhrit, ose faltoria e tij.  
Jetë e acarët në një esencë, në një shenjë.

## PADURIMI I FEMRËS

Ajo:  
Mendova se do shkëputesh nga këto soj gjérash;  
Kështu më duhet të duroj një të dashur.  
Jam gruaja yte. Mbaj unazën e martesës me ty.  
Nuk jam një hënë, një perlë, një manushaqe.


Ai:  
Por unë mund të shoh në anën tjetër,  
Xhevahiret e kuqe si gjak fshehur në minierë,  
Një mijë puplat që shushurinë në vesë,  
Të mosnjohjet e shenjtërisë së vetes.

Ajo:  
Burimet e tua të vjetra gjithmonë kështu flasin.  
Duhet të jesh mirenjohës. Unë dhashë mjart  
Të jetoj me ty. Por Xhuliet nuk jam.

Ai:  
Poeti mund t'i shohin xhevahiret në krahët e tu,  
Dhe natyrën me çfarë mrekullie kemi të bëjmë:  
Ç'te bej nëse bukuria jote këndon?

## ME GRUPIN E TEORICIENËVË NË SANTIAGO DE COMPOSTELA

Sot e zgjodha misterin e kohës.  
Por nuk qesh unë ai që e zgjodhi atë. Qe ai  
Turisti i shkëlqyer i barokes sublime?  
Jo. Në mos qe katoliku në Faltore?



Ballina e librit

Më pak se aq, madje, më pak se ai pikniku  
Dehës prej vere riën qiejt Galician  
Apo ai profesori vendas amerikan  
Duke goditur topin me teoricienët?

Atëherë kush qe ai që e zgjodhi atë? Aty rrjia;  
I ngathëti i parë, i kujtuari i paradigmës,  
I prirë tek e dyta, e treta mbas asaj,

The tani argumenti i brendshëm i kohës  
Fillon në vettvetë, në mua, të deklarojnë huqet,—  
Unë, ndërkokë, tashmë i pavetëdijshëm për krimin.

## NË KAFENË FILMI

### Lisbonë

Qiejt Magrittë dhe pema e mesnatës herët në muzg:  
Diçka sigurisht po ndodh këtu.  
Është gjithçka e mrekullueshme. S'ka pasur kohë të mjaftueshme

Që gjithçka të shtyhet te ekzistencia.  
Duhet të jetë tërhequr njëkohësisht. Unë ulëm  
Në këtë teh të kësaj mrekullie, Lisbonë,  
Me kështjellat e saj dhe barokët;  
Dhe si prej një pemë uji të pa sterilizuar,  
Mund të vinte gjithçka?—  
Këta Francezë të zemëruar?

Muri rozë me dritaret e veta,  
Të ndriçuara në verë—ar blu gjë përbuzë qillit?  
Studentët në shesh  
Duke vështruar njëri-tjetrin?  
Pas një darke të mirë  
Nganjëherë një shkumë e çuditshme  
E tërhequr nga një rrëshirë, me shije rakie dhe kafeje,  
Dhe papajave, një mukozë engjëllorë  
Që duhet të jetë nektar i pahijshëm  
Të cilin zotët e vjetër pëlqenin të pinin.

## NË AKUARELET E VILËS SË MISTEREVE, POMPEI

Kemi harruar se sa të ashpër zotët  
Mund të jenë. Mizoria të jesh vajzë:  
Si mund të jetë i droguar me mashtrime një njeri racional  
Kaq bindëse, e zënë në sorollatjen e tij  
Kimi, lotët e saj të dala jashtë si plaqë  
Të enjitura me qelb, megjithatë ajo ka shëndet perfekt—  
Zoti e rreh atë; si gjithmonë femërisë  
Të joshur nga etja e saj për gjak të vjedhur,  
Sepse dhimbja është aq qmendurake sa  
Ajo është në dashuri me atë mizori të ftotë  
Dhe kundra kësaj të kueje të Pompeut duhet të jetë  
Shtyrë në sakrifica të papërbullueshme  
Kur asaj i duhet të japë kupën e gjakut të Krishtit  
Të ushqejë metamorfoza e errëta, si ju.